

Qershor 2026

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E DEGËS TERRITORIALE TË SHËRBIMIT TË PROVËS TIRANË



Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, u prit në një takim nga drejtuesit e Degës Territoriale të Shërbimit të Provës në Tiranë. Gjatë takimit u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit dhe përmirësimin në referimin e rasteve.

MBËSHTETJA E AKSESIT TË QYTETARËVE NË DREJTËSI NËPËRMJET NDËRMJETËSIMIT NË SHQIPËRI

Përfaqësues nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, së bashku me specialistet pranë QSHNJP Fier dhe Vlorë, në datën 03.06.2026, morën pjesë në seminarin e zhvilluar në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, CSSP dhe QSHPLI. Në takim u diskutua mbi kontributin që mund të japë secili institucion në referimin dhe trajtimin e denjë të personave të cilët i drejtohen ndërmjetësve.



TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E DEGËS TERRITORIALE TË SHËRBIMIT TË PROVËS TIRANË

Drejtoresha e Përgjithshme (e komanduar) e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe, zhvilloi një takim koordinues me katër organizatat jofitimprurëse përfituese të financimit nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore për vitin 2026.



TAKIM ME STUDENTËT PRAKTIKANTË TË ANGAZHUAR PRANË QSHNJP TIRANË



Përfaqësues të Sektorit të Administrimit të Ofruesve të Ndihmës Juridike Parësore zhvilluan një takim me studentët praktikantë të angazhuar pranë QSHNJP Tiranë dhe specialistet të cilat punojnë pranë kësaj qendra. Takimi u zhvillua lidhur me mundësitë e përmirësimit të ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve.

AKTIVITETE TË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

QSHNJP Durrës, në datën 08.06.2026, zhvilloi një aktivitet informues “Street Law”, ku qytetarët u informuan mbi të drejtën për ndihmë juridike falas.



QSHNJP Durrës, në datë 30.06.2026, mori pjesë në një trajnim mbi zgjerimin e ndihmës juridike falas për personat me aftësi të kufizuara, ku prezantoi rolin e qendrave të ndihmës juridike në garantimin e aksesit në drejtësi.



QSHNJP Përmet, në datë 12.06.2026, mori pjesë në një takim ndërinstitucional për të diskutuar aksesin në drejtësi të personave me aftësi të kufizuara, ku u evidentuan sfidat, nevoja për bashkëpunim institucional dhe rëndësia e garantimit të mbështetjes juridike efektive

QSHNJP Përmet, në datë 29.06.202, zhvilloi një aktivitet informues “Street Law” në Tepelenë, ku qytetarët u informuan mbi të drejtat e tyre ligjore.



QSHNJP Pukë, në datë 01.06.202, zhvilloi takime informuese në Njësine Administrative Luf-Qerret dhe Qendrën Shëndetësore Luf, ku u diskutua për ndihmën juridike falas.



QSHNJP Pukë, në datë 02.06.2026, zhvilloi takime informuese ku prezantoi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe shpërndau materiale informuese për referimin e rasteve në nevojë, në Njësine Administrative Iballë.



QSHNJP Pukë, në datë 08.06.2026, zhvilloi një takim me Myftininë e Pukës, ku u diskutuan problematikat ligjore të qytetarëve, shërbimet e ndihmës juridike falas dhe forcimi i bashkëpunimit për referimin e rasteve në nevojë.



QSHNJP Pukë, në datë 10.06.2026, zhvilloi aktivitete informuese në Njësitë Administrative Rrapë pranë Qendrës Shëndetsore dhe Qafë-Mali.




QSHNJP Shkodër, në datë 01.06.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, zhvilloi një takim informues me fëmijët dhe stafin e Shtëpisë së Fëmijëve në Shkodër.



QSHNJP Shkodër, në datë 18.05.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, zhvilloi një aktivitet informues “Street Law”.



QSHNJP Shkodër, në datë 02.06.2026, mori pjesë në forum dialogun ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve publike, organizuar nga Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit, Shkodër.



QSHNJP Shkodër, në datë 03.06.2026, mori pjesë në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga OJF “Hapat e Lehtë” dhe Bashkia Vau Dejës.

QSHNJP Shkodër, në datë 04.06.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve Viktima të Agresionit, zhvilloi një takim informues në Strehëzën “Shtëpi Familje”.



QSHNJP Shkodër, në datë 08.06.2026, informoi komunitetin në zonën “Tepe” mbi të drejtat për ndihmë juridike falas.

QSHNJP Shkodër, në datë 09.06.2026, mori pjesë në Panairin Gjithëpërfshirës të Punësimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, ku ofroi informim dhe këshillim mbi ndihmën juridike falas dhe mbrojtjen e të drejtave të kësaj kategorie.



QSHNJP Shkodër, në datë 11.06.2026, në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, zhvilloi një takim informues me nxënësit e Gjimnazit "28 Nëntori" mbi të drejtat e të miturve, mbrojtjen nga dhuna dhe përfitimin e ndihmës juridike falas.




QSHNJP Shkodër, më datë 22.06.2026, zhvilloi një aktivitet informues me grupin rinor të Katedrales, ku të rinjtë u informuan mbi të drejtat e tyre dhe përfitimin e ndihmës juridike falas.

QSHNJP Shkodër, në datë 24.06.2026, mori pjesë në një takim në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit, ku prezantoi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe orientoi pjesëmarrësit për zgjidhjen e problematikave të tyre.



QSHNJP Gjirokastrë, në kuadër të 4 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve Viktima të Agresionit, në bashkëpunim me Zyrën Përmbartimore dhe Shërbimin e Provës, zhvilloi një aktivitet informues me nxënësit e IA Gjimnazit "Asim Zeneli".

QSHNJP Gjirokastrë, në datë 12.06.2026, pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë mori pjesë në një takim ndërinstytucional mbi aksesin në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara.



QSHNJP Gjirokastrë, në datë 12.06.2026, zhvilloi një takim pune, me përfaqësues të QSHPLI, DHKN, dhe shoqatës MKEZH, mbi bashkëpunimin në referimin e rasteve.




QSHNJP Gjirokastrë, në datë 16.06.2026, mori pjesë në një trajnim të organizuar në kuadër të projektit "Qasje gjithëpërfshirëse për të garantuar akses të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri".



QSHNJP Gjirokastrë, në datë 22.06.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar me rastin e Ditës Botërore të Refugjatëve, për të promovuar solidaritetin dhe mbështetjen për refugjatët, në bashkëpunim me UNHCR, Kryqin e Kuq Shqiptar dhe institucionet vendore.



QSHNJP Mat, në datë 01.06.2026, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, zhvilloi një aktivitet informues në formën "Street Law" në Kopshtin Nr. 1.



QSHNJP Mat mori pjesë në takimin dy ditor me titull: "Takim i rrjetit të anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në bashkitë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos.

QSHNJP Fier, në datë 09.06.2026, në bashkëpunim me KMD, zhvilloi një takim informues në Njësinë Administrative Strum, ku qytetarët u njohën me shërbimet e ndihmës juridike falas.



QSHNJP Fier, në datë 17.06.2026, zhvilloi një takim me përfaqësues të Shërbimit të Provës dhe KMD për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe përmirësimin e procedurave të referimit dhe ofrimit të shërbimeve juridike.

QSHNJP Fier, në datë 24.06.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga KMD në Njësinë Administrative Grabjan, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit.



QSHNJP Vlorë, në datë 01.06.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, organizoi një aktivitet informues në terren,



QSHNJP Vlorë, në datë 05.06.2026, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues në terren, ku shpërndau materiale informuese mbi shërbimin e ndihmës juridike falas, informoi qytetarë vendas dhe të huaj, si dhe referoi dy raste pranë zyrës për trajtim të mëtejshëm.



QSHNJP Vlorë, në datë 24.06.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit, zhvilloi një aktivitet informues në terren me komunitetin egjiptian, duke promovuar të drejtën për ndihmë juridike falas.

QSHNJP Berat, në datë 23.06.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Berat dhe QZHK "Sot për të Ardhmen", ku u prezantuan shërbime të reja sociale për gratë dhe vajzat e komuniteteve rome dhe egjiptiane.



QSHNJP Elbasan zhvilloi një aktivitet informues në kuadër të 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

QSHNJP Elbasan, në datë 04.06.2026, mori pjesë në tryezën e rrumbullakët "Fuqizojmë Gratë dhe Vajzat për një Jetesë më të Pavarur", ku u diskutua mbi fuqizimin e grave dhe vajzave, aksesin në shërbime, bashkëpunimin ndërinstytucional dhe promovimin e aksesit në drejtësi për grupet në nevojë.



QSHNJP Elbasan, në datë 04.06.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve Viktima të Agresionit, zhvilloi një aktivitet informues në terren, duke informuar qytetarët mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe kategoritë e përfituesve sipas ligjit nr. 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti".

QSHNJP Elbasan, në datë 12.06.2026, zhvilloi një takim me përfaqësuesin e Prokurorisë Elbasan, me fokus forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, përmirësimin e mekanizmave të referimit të rasteve dhe rritjen e koordinimit për ofrimin e ndihmës juridike falas për qytetarët në nevojë.



QSHNJP Elbasan, në datë 22.06.2026, zhvilloi një takim informues me punonjës të Komisarariatit të Policisë Elbasan, ku u prezantuan shërbimet e ndihmës juridike falas, u diskutua mbi mekanizmat e referimit të rasteve dhe u forcua bashkëpunimi për garantimin e aksesit efektiv të qytetarëve në drejtësi.



QSHNJP Elbasan, në datë 23.06.2026, zhvilloi një takim me Dhomën Vendore të Ndërmjetësimit Elbasan, ku u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit dhe mekanizmave të referimit të rasteve, me synim përmirësimin e aksesit të qytetarëve në drejtësi dhe ofrimin e shërbimeve sa më efektive.

QSHNJP Lezhë, në datë 01.06.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Lezhë, me qëllim promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë e mbrojtjes dhe mirëqenies së tyre.




QSHNJP Lezhë, në datë 11.06.2026, mori pjesë në ceremoninë e nisjes së punimeve për ndërtimin e Qendrës Ditore të Moshës së Tretë në Lezhë, ku u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe e investimeve në mbështetje të mirëqenies dhe përfshirjes sociale të të moshuarve.




QSHNJP Korçë, në datë 01.06.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve zhvilloi një takim informues me përfaqësues të Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen, ku u diskutua mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

QSHNJP Korçë, në datë 04.06.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve të Pafajshëm Viktima të Agresionit, në bashkëpunim me Avokatin e Popullit dhe KMD, zhvilloi një takim në Komisarjatin e Policisë Pogradec.



QSHNJP Korçë, në datë 12.06.2026, mori pjesë në një trajnim për rritjen e kapaciteteve mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe garantimin e aksesit të barabartë në drejtësi.

QSHNJP Korçë, në datë 23.06.2026, në kuadër të Ditës Botërore të Refugjatëve, mori pjesë në aktivitetin "Ecim së Bashku", me qëllim promovimin e solidaritetit, mbështetjes dhe përfshirjes së refugjatëve dhe personave të zhvendosur.



QSHNJP Korçë, në datë 24.06.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit, mori pjesë në takimin "Edukimi dhe Fuqizimi i Vajzave dhe Grave Egjiptiane", ku u promovua fuqizimi i grave dhe vajzave egjiptiane dhe rëndësia e bashkëpunimit për garantimin e aksesit të barabartë në të drejtat e tyre.

QSHNJP Dibër, në datë 04.06.2026, mori pjesë në një tryezë konsultimi mbi fuqizimin ekonomik të grave rurale, ku u diskutua rritja e aksesit të tyre në të drejtat pronësore, financa dhe ndihmë juridike falas, si dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional për adresimin e sfidave në këtë fushë, në qytetin e Peshkopisë.



QSHNJP Dibër, në datë 22.06.2026, zhvilloi një takim në Njësinë Administrative Tomin, ku u diskutua mbi zbatimin e ligjit nr. 111/2017, trajtimin e problematikave të qytetarëve dhe forcimin e bashkëpunimit me strukturat vendore për referimin e rasteve dhe ofrimin e ndihmës juridike falas.

QSHNJP Kurbin, në datë 10.06.2026, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kurbin zhvilloi një takim ndërinstitucional me Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore Kurbin, ku u diskutua mbi mekanizmat e referimit të rasteve dhe forcimin e bashkëpunimit për trajtimin sa më efektiv të problematikave të qytetarëve.



QSHNJP Tropojë, zhvilloi një takim ndërinstitucional pranë Njësisë Administrative Tropojë.

QSHNJP Tropojë, zhvilloi një takim informues mbi ndihmën juridike falas me stafin e Qendrës Shëndetësore Aste.

QSHNJP Tropojë zhvilloi një aktivitet "Street Law" që synon të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtën për ndihmë juridike falas dhe mënyrat e aksesimit të saj.



QSHNJP Tropojë në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimit të qasjes së qytetarëve në shërbime publike, zhvilloi një takim me përfaqësues të Zyrës së Punësimit dhe Aftësive Tropojë.



QSHNJP Tropojë, në datë 29.06.2026, zhvilloi një takim pranë Njesisë Administrative Fierzë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe koordinimin e veprimeve për ofrimin sa më efektiv të shërbimeve të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Tropojë, në datë 29.06.2026, zhvilloi një takim me stafin e Qendrës Shëndetësore Fierzë, me fokus forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për identifikimin, informimin dhe referimin e viktimave të dhunës për përfitimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Tropojë, zhvilloi një takim ndërinstitucional me përfaqësues të Bashkisë Tropojë, Shërbimit të Provës, Komisarariatit të Policisë Tropojë, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe Zyrës Përmbarimore.



QSHNJP Kavajë, në datë 01.06.2026, ishte subjekt i vizitës monitoruese të Komsionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik. Vizita Monitoruese u bë në ambientet e IEVP për të mitur në Kavajë.



QSHNJP Kavajë, në datë 08.06.2026, në bashkëpunim me Qendrën e Ndhmës Juridike Parësore Durrës dhe me Klinikën Ligjore pranë Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës organizoi një “ Street Law” në qendër të qytetit të Durrësit.



QSHNJP Kavajë, në datë 09.06.2026, ishte pjesë e tryezës ndërinstitucionale të organizuar nga Ministria e Drejtësisë me temë “Aksesi i të Miturve në Drejtësi”.

QSHNJP Kavajë, në datë 30.06.2026, ishte e ftuar në trajnimin e organizuar nga Fondacioni “ Së Bashku”, në kuadër të projektit “ Zgjerimi i ndihmës juridike falas për personat me aftësi të kufizuara në Durrës dhe Kavajë.

